



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Komiteti për Politikë e Financa

Nr.02 379

Datë: 28.06.2019

PROCESVERBAL

I mbledhjes së -VI- (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -V- të KPF-së.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/115 datë:17.06.2019, e parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2020-2022.
3. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/347 datë:11.06.2019 për miratimin e Raportit për performancë komunale për vitin 2018.
4. Shqyrtimi i kërkesës nr.03/281 datë:17.06.2019 e parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Administratë, për miratimin e draft-Rregullores për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Malishevës.
5. Shqyrtimi i raportit për përgatitjet e korrije-shirjeve nga Drejtoria për Bujqësi.
6. Përgatitjet për pritjen e bashkatdhetarëve të Komunës së Malishevës.
7. Shqyrtimi i kërkesave .
8. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë: 20.06.2019, filloi në ora:10:25. Morën pjesë 4 anëtarët e Komitetit si dhe Osbe.

Rrahim Morina: Ju përshendes dhe faleminderit që keni ardh. Materialin besoj e keni marrë me kohë, pasi që është thirrë mbledhje e jashtëzakonshme, por në ftesë është gabuar. Kush është për rendin e ditës? Për: 4 unanimsisht.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -V- të KPF-së

Rrahim Morina: Urdhëroni aë don dikush fjalën për procesverbalin e mbledhjes së pestë, a keni ndonjë vërejtje, nëse jo kush është për? Për: 4 unanimsisht.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/115 datë:17.06.2019, e parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2020-2022.

Rrahim Morina: Vazhdojmë me pikën e dytë, është fjala për Kabin kornizën afatmesme buxhetore, a keni diqka rreth kësaj pike ?

Hashim Vrenezi: Unë vetëm deshta më thënë që po e rekomandojmë për Kuvend, ndryshimet dhe vërejtjet tona i bëjmë atje, edhe pse kjo është një kornizë në vija të trasha dhe nuk besoj që mundemi me lëvizë shumë.

Rrahim Morina: Kush është për që t'a rekomandojmë për kuvend? Për: 4 unanimit.

3. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/347 datë:11.06.2019 për miratimin e Raportit për performancë komunale për vitin 2018.

Rrahim Morina: Në këtë pikë e kemi raportin e performancës komunale, ajeni që ta rekomandojmë edhe këtë raport për kuvend, kush është për? Për: 4 unanimit.

4. Shqyrtimi i kërkesës nr.03/281 datë:17.06.2019 e parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Administratë, për miratimin e draft-Rregullores për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Malishevës.

Rrahim Morina: Kjo është një rregullore që për herë të parë aprovohet në kuvendin komunal, është mirë që të kemi një rregullore për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare, është një model nga komuna e Rahovecit, ku thotë se kryetari e përdor veturën 24 orë, ndërsa kryesuesit dhe nënkryetari u jepet me një vendim të veçantë ta mbajnë për 24 orë. Por unë mendoj që kryetari dhe kryesuesi duhet t'a mbajnë veturën 24 orë ndërsa nënkryetari jo. Hap debat për këtë pikë.

Valon Krasniqi: Edhe unë pajtoj që kryetari dhe kryesuesi t'i mbajnë automjetet zyrtare 24 orë, sepse të dy përfaqësojnë organe të larta, njëri ekzekutivin e tjetri kuvendin komunal.

Hashim Vrenezi: Ne në buxhet e kemi pas me sa di, që kryesuesi me pas një veturë zyrtare personale. Unë si propozim e kam që kryesuesi me pas një veturë, ndoshta jo 24 orë, sepse kryesuesi nuk ka angazhime e takime jashtë orarit të punës, por që e njejta veturë me u përdorë për grupet e asambleistëve të cilët bëjnë vizita ose takime.

Rrahim Morina: Të gjithë kryesuesit e komunave, i kan veturat 24 orë, unë vlersojë që kryetari dhe kryesuesi me i pas veturat unë e kam këtë mendim, sepse nuk po e kërkoj pse jam unë kryesues, por secili kryesues që vjen në pozitë t'a ketë veturën, ndërsa nënkryetari vetëm në orarin e punës.

Raimonda Krasniqi: Ne mandatin e kaluar kryesuesi i asamblesë a ka pas veturë zyrtare a po, jo, dmth a ka ekzistuar edhe në atë kohë rregullorja.

Hashim Vrenezi: Po e rekomandojmë edhe këtë rregullore për kuvend, aty diskutojmë më shumë.

Rrahim Morina: Jo nuk ka pas rregullore mandatin e kaluar. Kush është për? Për: 4 unanimit.

5. Shqyrtimi i raportit për përgatitjet e korrje-shirjeve nga Drejtoria për Bujqësi.

Rrahim Morina: Ne nuk kemi material për këtë pikë, sepse drejtoria e Bujqësisë nuk na ka sjellë, që doni e lejmë në rend dite për mbledhjen e kuvendit.

Raimonda Krasniqi: Po e rekomandojmë për kuvend, pastaj nëse na e sjellin materialin e diskutojmë.

Rrahim Morina: Kush është që ta rekomandojmë për kuvend? Për: 4 unanimisht.

6. Përgatitjet për pritjen e bashkatdhetarëve në Komunës së Malishevës.

Rrahim Morina: Edhe për këtë pikë material nuk kemi, si zakonisht kryetari bashkë me drejtorinë e kulturës kanë bërë përgatitje, po ashtu e kemi edhe komitetin për diasporë i cili ka aktivitet ndoshta. Ne po e rekomandojmë për kuvend dhe e diskutojmë aty. Për: 4 unanimisht.

7. Shqyrtimi i kërkesave .

Rrahim Morina: Kërkesa i kemi disa, për ndërrim destinim, si dhe për ndihma shëndetësore. Kërkesa e Halit Mazrekut për ndërrim destinim të tokës është në rregull, a jeni për me rekomandu? Për: 4 unanimisht. Kërkesa tjetër është e Jetfir Mazrekut për ndërrim destinim.

Hashim Vrenezi: Kësaj kërkesës së Jetfirit po i mungon kopja e letërnjoftimit, gjendja e re, gjendja e vjetër, arte foto.

Raimonda Krasniqi: Po ashtu edhe sipërfaqja e tokës që don me e shfrytëzu për ndërtim.

Rrahim Morina: Kërkesa e Fehmi Kryeziut, letërnjoftimi as nuk po i lexohet kësaj kërkesë.

Hashim Vrenezi: Të njëjtat gjëra po i mungojnë edhe Fehmiut.

Rrahim Morina: Ali Feriz Mazreku, i paska në rregull të gjitha dokumentet. Kalojmë të kërkesa e Fadil Thaçit.

Hashim Vrenezi: Edhe Fadilit po i mungon formati për ndryshimin e tokës që ka me bërë, nga gjendja e vjetër në të re.

Rrahim Morina: Kush është për, që edhe këto kërkesa të rekomandohen për kuvend? Për: 4. Kërkesat për ndihmë, njëra e ka cek shumen ndërsa tjetra jo, unë propozojë me 500 euro me i ndihmu Refki Zulfaj për bashkëshorten që e paska operu prej tumorit në kokë, dhe në dokumente po u saktësojka gjendja e saj e rëndë.

Hashim Vrenezi: Shkojmë me këtë propozim pra, 500 euro për bashkëshorten e Refki Zulfaj.

Rrahim Morina: Hisen Maliq Morina nga fshati Astrazup edhe ky ka kërku ndihmë për sëmundje është i pa aftë për punë, por ky e ka cek vlerën 500 euro për trajtim mjekësor. Kush është për që t'i ndihmojmë këto dy raste me nga 500 euro? Për: 4 unanimisht.

Valon Krasniqi: A ju nxjerrin problem qytetarëve këto ndihma që po i bëjmë ne, nëse ata janë raste sociale.

Rrahim Morina: Jo nuk i nxjerrin problem.


8. Të ndryshme.

Rrahim Morina: A keni me shtu diqka të pika të ndryshme. Nëse jo, unë po e përmbylli mbledhjen, faleminderit.

Mbledhja përfundoi në ora: 10:50

Procesmbajtësja

Verëlhinda Gashi



Kryesuesi i Komitetit

Rrahim Morina

